



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 322 Prot.

Tiranë, më 27.02.2023

V E N D I M

Nr. 34, Datë 27.02.2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 166 Regj., datë 03.11.2022, të shtetasit D. S¹, (përfaqësuar nga e ëma, E. S / përfaqësuese ligjore e tij) kundër Fakultetit të Arteve të Bukura Tiranë, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “aftësisë së kufizuar²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

E. S, e cila është përfaqësuesja ligjore e të birit D. S, diagnostikuar me çrregullime të spektrit autik (me vendim të KMCAP Tiranë), në ankesën e depozituar pranë KMD-së, informon Komisionerin, ndër të tjera se:

“D mbaroi studimet në Liceun Artistik në vitin 2020 dhe hyri në Akademinë e Arteve të Bukura, në degën e Pikturës/viti i parë, në 2020. Viti i parë u zhvilluar online dhe kur D u paraqit për të dhënë provimet, 2 (dy) nga profesorët e tij nuk e pranuan faktin që ai është me autizëm dhe për rrjedhojë nuk e kaluan duke e ngelur në provime. Dekani më ndaloi ta sjell edhe në provimet e tjera, duke ndikuar për keq në shëndetin e D dhe në socializimin e tij me shokët. Profesorët që

¹ Bazuar në aktin noterial me nr. / 158 kol, të Dhomës së Noterisë Tiranë dhe Vendimit me nr. 4907, datë 08.10.2019 të KMCAP i PAK Tiranë.

² Me vendimin nr. 4907, datë 08.10.2019 të KMCAP i PAK Tiranë është caktuar se D. S është PAK, grupi i parë nga data 01.12.2019 deri më datë 01.12.2022, me diagnozë çrregullim i spektrit autik dhe ka nevojë për përkujdesjen e vazhdueshme të një personi.

kanë ngelur D kanë kaluar disa studentë të tjerë që janë edhe ata me autizëm (por jo të gradës së D pasi D nuk arrin të komunikojë nëpërmjet të folurit) ndërsa D e paragjykojnë dhe nuk pranojnë ta klasifikojnë kalues vetëm për faktin që ai nuk arrin të flasë e komunikojë si të tjerët. Por D komunikon nëpërmjet pikturave të tij, sepse ky është pasioni e talenti i tij më i madh”.

Ankuesja ka pretenduar se i biri është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të padrejtë me studentët që kanë aftësi të kufizuar si i biri i saj (duke përmendur emrin e studentit me çrregullime të spektrit autik që ndjek studimet për violinë dhe ka emrin Nikolas, por nuk ja di mbiemrin), dhe se është bullizuar nga pedagogët për shkak të aftësisë së tij të kufizuar, duke e mos e klasifikuar si kalues në dy vitet e studimeve të tij 2020-2021 dhe 2021-2022. Ajo është shprehur se nga ana e punonjësve, pedagogë të Akademisë i është pohuar se nuk duan ta kalojnë djalin e saj, pasi ai është autik.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatohet diskriminimi ndaj D. S nga ana e Fakultetit të Arteve të Bukura (FAB)/Universiteti i Tiranës, pasi ata e kanë përjashtuar atë nga e drejta e vijimit të studimeve në vitin e dytë, si dhe ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për të bërë të mundur që për D. S me çrregullime të spektrit autik të ndërmjetësohet për t'i krijuar lehtësira dhe mundësi për klasifikimin e tij si kalues për vitin aktual 2022-2023.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës së mësipërme, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- 1.** Nëpërmjet shkresës me nr. 1429/1 prot., datë 11.11.2022, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrim FAB, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

Në vijim, nëpërmjet shkresës me nr. prot. 172, datë 18.11.2022, FAB, ka njohur Komisionerin me qëndrimin e tij lidhur me pretendimet e subjektit ankues, duke theksuar, ndër të tjera se:

- *“Ky është rasti i parë që Fakulteti përballet me një rast të tillë dhe, me gjithë ekspertizën që kemi kërkuar jashtë Universitetit nuk kemi arritur të ndërtojmë një protokoll se si do të realizojmë procesin mësimor me këtë student (i cili rezulton mbetës në 6 (gjashtë) lëndë, kryesisht teorike). Ekziston një boshllëk i madh ligjor përse i përket*

aksesueshmërisë apo trajtimit të personave me aftësi të kufizuara në përgjithsi dhe atyre me spektër autik, në veçanti, në Institucionet e Arsimit të Lartë. E gjithë çështja qëndron në verifikimin e mësimit dhe kontrollin e dijeve në mënyrë të veçantë në lëndët teorike.

- *Ne kemi dy mënyra në kontrollin e dijeve në këto lëndë: kontroll me shkrim dhe me përgjigje me gojë. Në të dyja këto mënyra nuk kemi arritur të komunikojmë me studentin D. S. Për këtë arsye, e shohim të nevojshme ndërhyrjen e një ndërmjetësi, si p.sh. një “ndihmësi personal” në përputhje me parashikimet e ligjit me nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara ose çdo lloj mënyre tjetër që mundëson komunikimin...etj”.*
- *Jemi përpjekur për të ndërtuar një program të veçantë për studentin në fjalë, por ka qenë e vështirë në lëndët teorike të përcaktoshin tema për të cilat studenti mund të kishte një përfshirje ose preferencë, të cilat mund të merreshin në konsideratë për “output-in” e lëndës. Kemi konkluduar pjesërisht në lëndët karakterizuese pikurë (Teori ngjyre; Teori fushe dhe Vëllim në hapësirë) ku “komunikimi” ka qenë vizual dhe rezultatet janë mjaftueshmërisht pozitive. Gjithsesi në këtë marrëdhënie nuk mund të flasim për një metodë të përcaktuar, por për një proces të improvizuar, në varësi të gjendjes emocionale të studentit, duke konsideruar dhe mospjesëmarrjen e tij në procesin mësimor.*
- *Në FAB nuk rezulton asnjë ankesë me shkrim e subjektit në fjalë. Ne jemi në kontakt me nënën e D, përfaqësuesen ligjore të tij, e cila ka shprehur vazhdimisht shqetësimin në mënyrë verbale dhe i gjithë stafi ka qenë i përfshirë për ta ndihmuar në procesin mësimor studentin në fjalë.*
- *Fakulteti është në dijeni mbi diagnozën e çrregullimeve të spektrit autik (grupi i parë) nëpërmjet raporti mjekësor të D. Vetë subjekti ka përfituar statusin e studentit nëpërmjet kuotave për kandidatë me aftësi ndryshe që Institucioni ka për këto kategori”.*

Në përfundim të shkresës, FAB, pavarësisht kompleksitetit të çështjes ka shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar në zgjidhjen e kësaj situatë.

2. Nëpërmjet shkresës me nr. 1429/3 prot., datë 13.12.2022, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime dhe informacion MAS, si më poshtë:

- A ka patur ankesa të mëparshme pranë MASR-së lidhur me një problematikë të ngjashme më atë të studentit D. S? Nëse po, citoni rastet dhe cila është praktika e ndjekur prej jush?
- A ka MASR një plan masash apo praktikë lidhur me studentët me AK, konkretisht me çrregullime të spektrit autik? Nëse po, Ju lutemi të vini në dispozicion të KMD-së kopje të dokumentacionit. Nëse jo, parashtrimet tuaja.
- Në kushtet kur për këtë kategori studentësh të cilët janë të përfshirë në VKM specifike si studentë përfitues të kuotave të veçanta për të ndjekur arsimin e lartë, pikërisht për shkak të AK së tyre, si dhe në mungesë të parashikimeve ligjore specifike lidhur me trajtimin e

tyre në kontrollin e dijeve e mësimnxënies, në përputhje me ligjin nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe akueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, si dhe ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, cilat janë masat e ndërmarra nga ana e MASR-së në parim, dhe konkretisht për rastin në fjalë, pas marrjes dijeni të kësaj problematike (të studentit D. S) nga Komisioneri?.

Në vijim, nëpërmjet shkresës me nr. prot. 7526/3, datë 22.12.2022, MAS, ka njohur Komisionerin me qëndrimin e saj lidhur me pretendimet e subjektit ankues, duke shprehur ndër të tjera, se:

“...Zbatimi i përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, realizohet nga strukturat kompetente pranë IAL-së, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e parashikuara për secilin organ individual apo kolegjial. Lidhur me rastin në fjalë, i takon strukturave të arsimit të lartë të veprojnë dhe të marrin masa në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për problematikat e konstatuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. Në këtë aspekt, MAS, respekton aktet e brendshme (Statut, Rregullore, etj) të IAL-ve, akte të cilat kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e këtyre institucioneve, ku përfshihen dhe rregullat për zhvillimin e procesit mësimor, mënyrat e të provuarit të dijes, organizimi i provimeve, etj, të cilat vendosen në bazë të autonomisë institucionale që ligji u njeh institucioneve të arsimit të lartë”.

3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 175 prot., datë 26.01.2023, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore³.

Seanca u zhvillua me datë 07.02.2023, me praninë e përfaqësuesve të dy palëve në proces. Ankuesi u përfaqësua nga nëna e tij, E. S dhe FAB u përfaqësua nga A.K, juriste pranë Sektorit Juridik/Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Informacionit-P/A/ Universiteti i Arteve dhe E.H, pedagog dhe Shef Departamenti pranë FAB. MAS u përfaqësua nga I. N, specialiste në Sektorin e Çështjeve Juridike Administrative, pranë Ministrisë.

Gjatë seancës, palët u qëndruan parashtrimeve të tyre të depozituara me shkrim në komunikimin shkresor me KMD-në. Nga ana e përfaqësuesve të FAB, u shpreh gatishmëria për të bashkëpunuar në kuadër të masave pozitive në mbështetje të kërkesave të D, lidhur me ngritjen e një grupi pune për të vlerësuar nevojat specifike të tij. U dakordësua nga palët në seancë që në

³ Secila nga palët, mund të depozitojë gjatë seancës, shpjegime si dhe dokumentacion provues në favor të argumentave të veta. Komisioneri kërkon të njihet nga ana e Fakultetit të Arteve të Bukura, me masat e ndërmarra në kuadër të pretendimeve të ankueses, nëse ka të tilla. Si dhe, kopje të dokumentacionit shkresor, nëse ka.

ditët në vijim, FAB do tu komunikonte subjektit ankues dhe KMD-së, masat konkrete që do të ndërmerren lidhur me rastin në fjalë.

Në vijim të sa më sipër, FAB, me e-mail-in datë 17.02.2023, ndër të tjera, informoi se:

“Ju bëjmë me dije se ndërmjet FAB dhe subjektit ankues (E. S përfaqësuese ligjore e studentit D. S) është dakordësuar për ta zgjidhur çështjen me mirëkuptim. Kështu, është arritur në një marrëveshje sipas dokumentit bashkëngjitur këtij mesazhi”.

Referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit, lidhur me datë 13.02.2023 ndërmjet palëve: FAB dhe përfaqësueses ligjore të studentit D. S, objekti i kësaj marrëveshjeje konsiston në vendosjen e një bashkëpunimi bazuar në kushtet e mirëbesimit dhe vullnetit të mirë, përta i përket përshtatjes së mësimdhënies dhe kontrollit të dijeve në përputhje me nevojat e studentit me çrregullim të spektrit autik.

Në nenin 4, të saj “Modalitetet e bashkëpunimit”, përcaktohet se:

“1. FAB zotohet të mundësojë një literaturë të reduktuar për lëndët teorike, e cila i përshtatet nivelit të kuptueshmërisë së Studentit.

2. Për lëndët që testohen teorikisht, FAB, do të garantojë vlerësimin e njohurive nëpërmjet testimit me shkrim, për shkak se aftësitë në shkrim të Studentit janë më të mira (sipas deklaratës së përfaqësueses ligjore të Studentit) se ato të komunikimit gojor, i cili mungon.

3. Përfaqësuesi ligjor i Studentit garanton se testimit me shkrim do t’i nënshtrohet vetë Studenti.

4. Provimi me shkrim zhvillohet në prezencë të kujdestares ligjore”.

Në vijim znj. S, përfaqësuesja ligjore e subjektit ankues, nëpërmjet email-it të datës 20.02.2023, informoi Komisionerin se vlerëson masat e ndërmarra nga FAB pas ndërmjetësimit të Komisionerit, dhe se tërhiqet nga ankesa, pasi kërkesa e saj kundrejt Fakultetit, ishte realizuar.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se:

“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative:

“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se:

“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 166 Regj., datë 03.11.2022, të shtetasit D. S, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime

Shkaku: AK

Lloji i vendimit: Arritje efektiviteti